

**QTKM – Qendra për Trainimin dhe Kualifikimin e Mësuesve**  
*Standardet e Performancës së Mësuesve*  
**16 Dhjetor 2005, Tiranë, Shqipëri**

## **Edukimi i Mësuesve si Pjesë e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë** **(Çfarë Strategjie nevojitet për Edukimin e Mësuesve?)**

**Pavel Zgaga**  
**Universiteti i Ljubljanes**

### **HYRJE**

*Edukimi dhe trainimi i mësuesve nuk është janë një ishull i izpluar.*

Mësuesit punojnë në mes të shoqërisë sonë; megjithatë, nganjëherë ata së bashku me nxënësit e tyre duket sikur janë të izoluar në klasa të sigurta. Sot, sistemet e edukimit dhe të trainimit kalojnë përmes sfidash dhe ndryshimesh. Dimesionet e tyre strukturore, sociale, dhe ndërkombëtare i nënshtrohen një reforme thelbësore.

*A sjellin këto ndryshime shanse dhe zhvillime të reja edhe në fushën e edukimit dhe trainimit të mësuesve, vecanërisht për profesionin e mësuesisë si një profesion që fitohet përmes arsimit të lartë?*

### **Reformat janë një domosdoshmëri, partneriteti gjithashtu**

Reformat e sistemeve të arsimit (të lartë) në Europë dhe në mbarë botën janë një domosdoshmëri që kushtëzohet nga një botë e cila ndryshon me shpejtësi :

- Zgjerimi i aksesit në arsim (terciar)
- Zhvillimi i “shoqërisë së dijes”
- Ndërkombëtarizimi i arsimit (të lartë)
- Lëvizshmëria, bashkëpunimi, konkurenca, ndërvarësia

Në Europën e sotme që po integrohet me shpejtësi, pavarësisht nga problemet, duket qartë nevojë për një forum të hapur, në të cilin qeveritë, universitetet, studentët dhe faktorët e tjerë të kenë mundësi të takohen dhe të diskutojnë për çështje që kanë të bëjnë me modernizimin dhe zhvillimin e arsimit të lartë. Ky forum është *procesi i Bolonjës (PB)*.

Hapësira Europiane e Arsimit të Lartë - **2010**

Qëllimi kryesor i Procesit të Bolonjës është krijimi deri në vitin 2010 i një *Hapësire të përbashkët Europiane të Arsimit të Lartë* (HEAL; 45 vende) me karakteristikat e mëposhtme :

- Njohja reciproke e kualifikimeve;
- Struktura kryesore e përbashkët e studimeve (tre cikle);
- Rregulla dhe procedura të pranuar për sigurimin e cilësisë;
- Shtigje më fleksibël studimi;
- Këndvështrimi i të mësuarit gjatë gjithë jetës në arsimin e lartë;
- Rritja e lëvizshmërisë së studentëve, të diplomuarve dhe mësuesve;
- Marrja parasysh e parimit të *mundësisë për punësim*, etj.

Në nivel *legjislativ*, përgjegjëse për implementimin janë autoritetet kombëtare, ndërsa në nivel *programi* përgjegjësinë e kanë institucionet e arsimit të lartë.

### **Aspektet strukturore vs. aspekteve të brendshme të përtëritjes**

Në procesin e përtëritjes, duket se interes më të madh paraqesin ndryshimet *strukturore*. Dhe vërtetë, në krahasim me modelet tradicionale, ndryshimet janë shumë të mëdha. *Tre cikle*:

- a) *cikli i parë / nëngraduat* (3-4 vjet, 180-240 kredite);
- b) *cikli i dytë / master* (1-2 vjet, 60-120 kredite);
- c) *cikli i tretë / doktoratura* (3-4 vjet, 180 kredite).

*Ndryshimet strukturore* janë të rëndësishme, por ato mund të realizohen plotësisht vetëm në kushtet e një *përtëritje të brendshme*. Vetë *filozofia* (konceptet) e *studimeve në arsimin e lartë është duke ndryshuar* – duke përfshirë edhe përgatitjen e mësuesve të ardhshëm.

→ ***Kuadri i Kualifikimeve në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë*** (Kopenhagen, Janar 2005 → Bergen 19 Maj 2005).

### **Kthesa e Kopernikut në Arsimin e Lartë**

Traditicionalisht, përfaqeset në arsimin e lartë kanë nisur nga *këndvështrimi i atyre që prodhojnë, zotërojnë dhe transmetojnë Dije*; e thënë më thjesht – nga *këndvështrimi i profesorëve*. Kjo ishte “pikëpamja e Arkimedit” për dijet akademike (tradicionale), dhe, të gjitha strukturat studimore, metodat e mësimdhënies dhe të të nxënit i nënshtroheshin kësaj pikëpamje.

Debati për arsimin e lartë, i cili ka ardhur në rritje gjatë dekadave të fundit, e kthen këtë pikëpamje në një drejtim krejt tjetër dhe *në një mënyrë të re e trajton atë nga këndvështrimi i atyre që kanë nevojë dhe kërkojnë Dije; e thënë më thjesht – nga këndvështrimi i studentëve* [dmth, *përfaqesja me në qendër studentin*]. Strukturat studimore, metodat e mësimdhënies dhe të të nxënit kanë nevojë për një pikëmbështetje të re konceptuale’.

## **Disa koncepte të reja**

**Kualifikim i arsimit të lartë:** “Çdo titull, diplomë apo çertifikatë tjetër e lëshuar nga një organ kompetent që vërteton përfundimin me sukses të një programi të arsimit të lartë” që është njësoj i rëndësishëm *si për punësim edhe për vazhdimin e studimeve.*

**Arritjet e të nxëniet dallohen nga qëllimet e të nxëniet :** ato kanë të bëjnë me *arritjet e një studenti dhe jo me synimet e përgjithshme të mësuesit.* Të shoqëruara me kritere transparente vlerësimi, ato përcaktojnë kërkesat (minimale) për të shpërblyer studentët me kredite.

**Kompetencat:** kombinime dinamiike të cilësive (që kanë të bëjnë me *dijet dhe zbatimin e tyre në praktikë, me qëndrimet dhe përgjegjësitë*) që përshkruajnë rezultatet e të nxëniet = *çfarë janë në gjendje të bëjnë studentët në përfundim të studimeve.*

## **Rezultati është më tepër se shuma mekanike e lëndëve.**

**Fleksibiliteti:** Mënyrat sipas të cilave një student lejohet të kombinojë kreditet (ngarkesën e punës; lëndët me zgjedhje) me qëllim që t’i japë *kualifikimit të vet profilit* që dëshiron (ose të zgjerojë kualifikimin e vet në këndvështrimin e të mësuarit gjatë gjithë jetës, p.sh. të marrë licencë për të dhënë mësim në një lëndë tjetër) duhet të mbajnë parasysh parimin se rezultati përfundimtar – titulli/diploma – është *më tepër se shuma mekanike e lëndëve/moduleve të vecanta.*

Më tej, **rezultatet e të nxëniet** përcatohen nga tre dimensione: *ciklet / nivelet e studimit* (përshkruet të arritjeve të të nxëniet në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë), *ngarkesa e studentit* (e shprehur në kredite) dhe *cilësia e një institucioni* (organizimi; kërkimi mësimdhënia, pajisjet, etj.).

## **Sigurimi i cilësisë (SC)**

→ **Standarde dhe Udhëzues për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë** (Grupi E 4; Shkurt 2005 → Bergen, 19 Maj 2005)

1. Rëndësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë; roli i studentëve.
2. Përdorimi i një tërësie standardesh Europiane të pranuar për sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë në kontekstin e Procesit të Bolonjës.
3. Krijimin e Regjistrit Europian të Agjencive të Njohura për Sigurimin e Cilësisë; shqyrtime periodike të agjencive për sigurimin e cilësisë.
4. Shtetet anëtare të Procesit të Bolonjës *duhet të bëjnë të mundur që universitetet të zgjedhin mes të gjitha këtyre agjencive (vlerësuese dhe & akredituese) që ndodhen në regjistrin Europian.*
5. Shtetet anëtare të Procesit të Bolonjës duhet të pranojnë vlerësimet e këtyre agjencive dhe t’i përdorin ato si bazë për vendimet që kanë të bëjnë me licensimin ose financimin e institucioneve të arsimit të lartë.

## **Arsimi i lartë nuk është një kullë e fildishtë**

Në shoqëritë moderne, arsimi i lartë ka shumë objektiva:

- Zhvillimin dhe ruajtjen e një baze të përparuar dijetsh;
- Përgatitjen për tregun e punës;
- Krijimin e mundësive për zhvillim profesional dhe
- Përgatitjen e studentëve për të jetuar si qytetarë aktivë në një shoqëri demokratike.

Pa autonomi nuk mund të ketë njohuri të përparuara; megjithatë, është e nevojshme që të gjithë faktorët të bashkëpunojnë në procesin e përgatitjes së kurrikulave si edhe në vlerësimin e cilësisë në universitete. Në edukimin e mësuesve kjo bëhet edhe më e rëndësishme sepse ai është *një fushë ndërdisiplinore, e cila kërkon që si laboratorin e vet të ketë “ambientin (e jashtëm) shkollor.*

## **Arsimi i lartë vs. Edukimit të mësuesve**

Shumë institucione të arsimit të lartë kanë filluar procesin e përtëritjes së kurrikulave në disiplina të ndryshme. Në disiplina të ndryshme dhe në fusha të ndryshme studimi ka filluar një bashkëpunim i gjerë ndërkombëtar edhe në përtëritjen e kurrikulave; duke përfshirë edhe edukimin e trainimit të mësuesve.

Rasti i projektit *SINKRONIZIMI*: mbi 150 universitete të vendeve të Procesit të Bolonjës “sinkronizojnë” kurrikulat e tyre në 9 fusha disipline, duke përfshirë edukimin dhe trainimin e mësuesve – shih <http://www.relint.deusto.es/TuningProject/index.htm>

Në kuadrin e “Axhendës së Objektivave 2010” vendet e BE i kushtojnë gjithashtu vëmendje zhvillimit të edukimit dhe trainimit të mësuesve – rrjeti *ENTEP*: jo vetëm edukimit fillestar të mësuesve nëpër universitete e kolegje, por edhe trainimit të tyre në detyrë dhe zhvillimit të pratneriteteve mes shkollave.

## **Disa nga gjetjet e projektit *Sinkronizimi***

Ka një larmi të pabesueshme traditash dhe sistemesh të edukimit dhe trainimit të mësuesve në Europë: Është e rëndësishme që ato të “*sinkronizohen*”; *sidoqftë*, duhet të shmanget rreptësisht çdo ‘*uniformizim*’ (‘*harmonizim*’).

Tre sistemet ciklike të Bolonjës ofrojnë mundësi më të mira për zhvillim dhe fuqizim në këtë në fushë.

Përtëritja brendshme (*kurrikulare*) e bazuar në koncepte të reja (p.sh., arritjet e të nxënit, kompetencat, kreditet etj.) bën të mundur hartimin e programeve të krahasueshme (lëvizshmëri, njohje, transferim, etj.) pa “uniformizuar” kurrikulat institucionale. Theksi kryesor është vënë tek modernizimi i metodave dhe përqasjes ndaj të nxënit, mësimdhënies dhe vlerësimit, duke përfshirë masat për sigurimin e brendshëm të cilësisë.

## **Parimet e Përbashkëta të BE për Kompetencën dhe Kualifikimin e Mësuesve**

Në BE e zgjeruar ‘sinkronizimi’ i kualifikimeve (jo vetëm terciare) për profesione të ndryshme është një nevojë në rritje: ka filluar tashmë ndërtimi i një kuadri të përbashkët kualifikimesh – duke përfshirë nivelin e lartë të arsimit të mesëm.

Vitin që shkoi (2004), Edukimi EC – DG ka filluar përgatitjen e një dokumenti të veçantë për kompetencat dhe kualifikimet e mësuesve dhe trainerëve. Ky projekt-dokument thekson rolin dhe rëndësinë e edukimit cilësor të mësuesve dhe trainerëve në kontekstin e strategjisë Europiane të Lisbonës.

*Edukimi dhe trainimi i mësuesve dhe trainerëve – në bashkëpunim të ngushtë mes shkollave dhe fakulteteve – është konfirmuar tashmë si një nga faktorët kyç për të hyrë në shoqërinë e dijes.*

### **A. Parimet e përbashkëta**

Profesioni i mësuesve dhe trainerëve është:

(1) *Një profesion universitar me një natyrë ndërdisiplinore që ndërlidh:*

- a) njohuri të përmajtjes lëndore,
- b) njohuri të pedagogjisë,
- c) shprehitë e kërkuara për udhëheqjen dhe mbështetjen e nxënësve,
- d) kuptimin e dimensinit social dhe kulturor të edukimit;

(2) Një profesion që vendoset brenda kontekstit të të mësuarit gjatë gjithë jetës (edukim dhe trainim në detyrë);

(3) Një profesion me lëvizshmëri (brenda Europës);

(4) Një profesion që mbështetet tek partneritetet (p.sh. Me shkollat, etj.).

Dhe së fundi, (është/duhet të jetë?!) një profesion tërheqës me një status të përshtatshëm në shoqëri!

### **B. Kompetencat kyce**

Mësimdhënia, trainimi dhe të nxënësve duhet të trajtohen në një këndvështrim më të gjërë; si në aspektin ekonomik, ashtu edhe në atë social e kulturor. Puna e mësuesve dhe e trainerëve kërkon zhvillimin e kompetencave të tyre në tre drejtime të njohura:

(1) *Puna me dijet, teknologjinë dhe informacionin;*

(2) *Puna me qëniet njerëzore (përfshirja, etj.);*

(3) *Puna me shoqërinë dhe në shoqëri (dimensioni kombëtar, European dhe global).*

Më 20-21 Qershor 2005, u organizua një konferencë e madhe në Bruksel për të verifikuar këtë axhendë para zbatimit zyrtar të Kompetencave dhe Kualifikimeve të Mësuesve nga organet politike të Bashkimit Europian (2006). Pjesëmarrësit e mbështetën fuqimisht atë.

### **Konkluzion**

Sot, është shumë i nevojshëm shkëmbimi i praktikave më të mira të bashkëpunimit ndërmjet vendeve. - Projekti për *Mbështetjen e Zhvillimit Profesional të Mësuesve dhe të Mësimdhënies* (2004-2006; 12 vende të Europës Juglindore – ku përfshihen Shqipëria dhe Slovenia) synon:

- Përdorimin e praktikave më të mira në rrethanat e veçanta të Rajonit të Europës Juglindore për të përmirësuar edukimin dhe trainimin e mësuesve në ambientet lokale,
- Shndërrimin e këtyre praktikave në pjesë përbërëse të realitetit institucional,
- Kontributin në zhvillimet kombëtare në fushën e edukimit dhe trainimit të mësuesve, dhe
- Përmirësimin e bashkëpunimit rajonal dhe European në edukimin dhe trainimin e mësuesve.